

V E N D I M
Nr.373, datë 12.8.1999

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË, TË
INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME “AMC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communication” (AMC) dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Forma e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC, të jetë tenderi i hapur me një fazë.

2. Ndërmjet investitorëve që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik, të publikuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ftesa për tender do t’u dërgohet vetëm kandidatëve, që përbushin kërkesat e parashikuara në kreun III të këtij vendimi, sipas afateve të parashikuara në të.

3. Investitorët strategjikë të interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre më të hollësishme, të detyrueshme, duhet të përbushin, paraprakisht, vetëm kërkesat e mëposhtme:

3.1.1. Të jenë shoqëri aksionere ose persona juridikë të ngjashëm, sipas legjislacionit të vendit ku ata janë krijuar, të jenë të krijuara dhe të regjistruara tek autoritetet përkatëse, ku ndodhet selia;

3.1.2. Do të pranohen edhe bashkime, të përbëra nga shoqëri aksionere apo persona juridikë të ngjashëm;

3.1.3. Do të pranohen dhe kombinimet e investitorëve, që veprojnë së bashku si koncern, për qëllimet e kësaj blerjeje apo që synojnë të kryejnë transaksionin nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet (“Shoqëria e re”);

3.2. Të kenë një kapital, tërësisht të paguar, jo më pak se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) USD apo ekivalentin e shumës, në valutën në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar, duhet të jetë të paktën 100 000 0000 (njëqind milionë) USD.

3.3 Të jenë operatorë rrjeti në industrinë e telekomunikacioneve, të cilat kanë siguruar shërbime telekomunikacioni gjatë dy viteve të fundit; në rast të konsorciumeve apo bashkimit të investitorëve, anëtar kryesor të përbushë kërkesat e përmendura.

3.4 Në rastin e kombinimit të investitorëve strategjikë me investitorë financiarë, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e aksioneve.

Të gjitha këto kërkesa do të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara zyrtare.

Palët, të cilat janë në likuidim apo nuk kanë aftësi pague, që janë nën administrim apo procedime të tjera, të ngjashme apo në ndonjë procedim që nënkupton paaftësi pague apo ndërprerje biznesi, nuk do të pranohen në procedurën e tenderit.

4. Pas analizës së shprehjeve të interesit dhe pas verifikimit për përbushjen e kërkesave të mësipërme prej investitorëve të interesuar, kompania këshilluese do t’i paraqesë për miratim

Komitetit Këshillues dhe të Transparencës listën e investitorëve, të cilëve do t'u dërgohet ftesa për tender, si dhe listën e investitorëve të skualifikuar.

5. Në përputhje me kreun II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin përkatës.

6. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me vendim të motivuar dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi, ruan në çdo moment, të drejtën:

- a) të tërhiqet nga procesi i shitjes apo ta ndërpresë atë;
- b) të përjashtojë ndonjë palë të interesuar nga procesi i shitjes, pa i njohur ndonjë pretendim për kompensim apo dëmshpërblim të çfarëdollojshëm të palëve të interesuara kundër Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko